



## Letër me lajme të reja për kosovarët në Danimarkë

---

Publikuar nga Enti Danez Për Ndihmë Të Refugjatve

Mars 2006

**Kjo letër me lajme të reja i dedikohet kosovarve ,të cilët planifikojnë që të kthehen parapë në Kosovë.Letra me lajme të reja publikohet nga Enti Danez Për Ndihmë Të Refugjatëve (Dansk Flygtningehjælp),e cila është një organizatë që punon e pamvarur nga interesat shtetërore dhe politike.**

---

Enti Danez Për Ndihmë Të Refugjatëve në pranverën e vitit 2006 është fokusuar në kthimin e azilkërkuesve dhe refugjatëve për në Kosovë.Arsyja është sepse Kosova sërishtë gjendet në një situatë relativisht stabile,ku shumë shqiptarë,serb,rom,ashkali etj kthehen në shtëpitë e tyre si nga rethet lokale ashtu edhe nga Evropa.Në qendrat e azilit danez në Danimarkë gjinden përafërsishtë 300 azilkërkues të refuzuar,dhe janë përafërsishtë x x persona nga Kosova me status të refugjatit.

Enti Danez Për Ndihmë Të Refugjatëve mbështet kosovarët që dëshirojnë të kthehen në vendlindje në Kosovë.Kjo vlenë si për azilkërkuesit e refuzuar ashtu edhe për refugjatët që kanë fituar lejeqëndrimi.Njoftimi ka për qëllim që ti informojë kosovarët pos tjerash për situatën në Kosovë dhe për mundësitë e mbështetjes(ndihmës) eventuale për tu kthyer

Nëse keni pyetje për Entin Danez Për Ndihmë Të Refugjatëve,mundeni të telefononi në gjuhën shqipe / serbokroate tek këshilldhënsi i ynë në numrin e telefonit 33735230 cdo të marte nga ora 1300-1400.

Lexo këtu njoftimet për :

- **Enti Danez Për Ndihmë Të Refugjatëve do të ftojë 3 persona nga Kosova në Danimarkë**
- **Situatën për kosovarët në Danimarkë**
- **Situatën për të kthyerit në Kosovë**
- **Oferta për Kosovarët në Danimarkë.**
- **Refugjatët me lejeqëndrimi mundë të marin mbështetje për tu kthyer në shtëpi**



**Enti Danez Për Ndihmë Të Refugjatëve do të ftojë 3 persona prej Kosove në Danimarkë.**

Prej dates 24 prill 2006 do të vinë 3 persona nga Kosova ku bashkë me Entin Danez Për Ndihmë Të Refugjatëve do ti vizitojnë kosovarët në Danimarkë dhe do ta diskutojnë situatën në Kosovë, pos tjerash mundësit për tu kthyer prapë. Ata tre persona janë të gjithë nga Kosova dhe punojnë për përmirsimin e mundësive të personave që kthehen prapë në Kosovë.

Informacionet më të hollësishme do të publikohen së shpejti

---

**Letra me lajme të reja për kosovarët në Danimarkë** është publikuar nga Enti Danez Për Ndihmë Të Refugjatëve. Redaktore përgjegjëse është Anne-Dorthe Helmich, Enti Danez Për Ndihmë Të Refugjatëve. Redaksia: Ole Larsen, Enti Danez Për Ndihmë Të Refugjatëve Borgergade 10,3. Postboks 53, 1002 København K. Tlf. 3373 5000. Fax 3391 4507. [www.flygtning.dk](http://www.flygtning.dk) Redaksia ka përfunduar me date 20. mars 2006. Letra me lajme të reja lejohet të kopjohet. Eksemplare tjera mundë të meren duke ju drejtuar Entit Danez Për Ndihmë Të Refugjatëve, Azil dhe Riatdhesim. Tlf. 337 35237. E-mail: [ole.larsen@drc.dk](mailto:ole.larsen@drc.dk)

## **Situata për kosovarët në Danimarkë**

Në Danimarkë janë duke qëndruar afër 300 azilkërkues nga Kosova, të cilët kanë marrë refuzim definitiv për azil. Shumica e të cilëve kanë marrë edhe refuzim për lejeqëndrimi humanitarë. Pritet që një numër i madhë me forcë të dërgohen në Kosovë.

Prej qershorit 2000 deri në gusht 2002 janë deportuar me forcë 88 persona. Mandej me përcjellje janë deportuar 8 persona në vitin 2003, 45 persona në vitin 2004 dhe 18 persona në vitin 2005. Deri për momentin në vitin 2006 asnjë person nuk është deportuar me përcjellje (të policisë) për në Kosovë. Policia e Danimarkës regullisht i drejtohet UNMIK-ut për ta orjentuar për deportet me forcë që do të ndodhin në të ardhmen për në Kosovë. Deri tash kjo ka ndodhë për shqiptarët etnik, goranët, boshnjakët dhe turqët etnik. Në regulloren e UNHCR, së mars 2005, është lënë hapur që pas një vlersimi konkret mundë të ndodhë deporti i ashkalive dhe egjiptianve etnik për në Kosovë. (Policia Shtetërore Departamenti Për Të Huaj), shkurt 2006).

Statistika dhe faktet për azilkërkuesit nga Kosova

- Në vitin 2005 dhe 2006 Jurijs Gjygsore Për Azilkërkuesit nuk ka dhanë lejeqëndrimi për kërkuesit e azilit nga Kosova.
- Në vitin 2003 dhe 2004 Jurijs Gjygsore Për Azilkërkuesit ka ndarë në 14 lëndë lejeqëndrimi për azilkërkuesit nga Kosova.
- Në vitin 2005 janë ndarë xx lëndëve lejeqëndrimi humanitarë.
- Deri më 4 shkurt 2006 kanë qenë 310 kosovarë aktual në pozicion para largimit, që do të thotë ata që kanë marrë refuzim definitiv për lejeqëndrimi në Danimarkë duhet ta lëshojnë shtetin.

Përpos azilkërkuesve të refuzuar, në Danimarkë jetojnë përafërsisht 1.000 refugjatë nga Kosova me lejeqëndrimi. Shumë pakë nga ata kanë pasur që kanë heqë dorë nga lejeqëndrimi i tyre në Danimarkë për tu kthyer në Kosovë.

---

## **Situata për të kthyerit në Kosovë**

Mbas luftës në vitin 1999 dhe rënujave të mëvonshme, Kosova dhe populli i sajë kanë përjetuar ndryshime të mëdha në këto vite. Kjo vlenë për papunsinë, zhvillimin e ulët ekonomik, niveli i ulët i shkollimit, kapaciteti i kufizuar i autoriteteve shtetërore, si dhe kriminaliteti. Pas tjerash Kosova gjindet edhe para zgjedhjes së statusit të ardhshëm të sajë.

Para dhe gjatë luftës së vitit 1999 një numër i madhë i personave me përkatsi të ndryshme nacionale kanë ikur nga Kosova. Si rezultat i kësaj në Serbi ende jetojnë përafërsisht 200.000 persona të deportuar nga Kosova kurse edhe më shumë në shtetet evropiane. Pas kësaj duhet shtuar

Letër me lajme të reja për kosovarët në Danimarkë, mars 2006

edhe 20.000 deportime interne në Kosovë. Gjithashtu ka edhe shumë persona që janë kthyer në Kosovë mbasi të kenë qenë të deportuar. Për këta vendimtare kaqenë që siguria ka qenë në rregull, mundë të fitojnë të ardhura relative, fëmijë të kenë casje në shkollë, dhe të ketë funksionim të sistemit të shëndetsisë.

### **Siguria dhe puna**

Komesariati I Lartë I Refugjatëve pranë Kombeve Të Bashkuara UNHCR vleron, se siguria dhe liria e të lëvizurit për përkatsitë etnike të minoriteteve në përgjithësi është në përparim në tërë Kosovën. Egzistojnë ende rethe në Kosovë ku psh. romët dhe përkatsitë e pakicave tjera etnike nuk janë të mirseardhura. Enti Danez Për Ndihmë Të Refugjatëve para një kohe të shkurtur ka qenë në kontaktë me organizatat e ndryshme lokale në Kosovë, të cilët raportojnë se situatë e sigurisë në shumicën e vendeve është mirrë, dhe se në kohët e fundit nuk ka patur sulme të dhunshme apo kërcënime kundër minoriteteve në rethet e përziera. Kjo vlenë për shembull në Gjilan ku jetojnë 450 romë në tre rethe të ndryshme dhe në Prizren janë duke jetuar 4.500 romë. Romët në Prizren pos tjerash kanë edhe qendrën e vetë kulturore.

Sipas informative nga shumë organizata, problemi kryesorë në Kosovë është papunsia e madhe, nga ku raportohet të të jetë ndërmjet 40 % deri 60 %. Kjo ndikonë shumë në problemet sociale dhe ekonomike në përgjithsi në Kosovë. Në mars të vitit 2005 ka startuar një program që ndihmohet nga Danimarka, me qëllim të përparimit të zhvillimit të zejtarisë dhe të punsisë në Kosovë.

Shuma e përgjithshme është 50 miliona Korona dhe afati i programit përfundon brenda 4 viteve duke filluar prej vitit 2005-2008. Në suazë të programit janë nënshkruar katër marrëveshje me institucionet për mikrokredite për shtimin e kapitalit huazues. Mikrokreditet funksionojnë si huazime me kamata të ulëta për zejtarët e vegjël, të mesëm dhe të mëdhenjë.

### **Shkollimi dhe shëndetsia**

Papunsia e madhe e vështëron sigurimin e rregullt të ardhurave elementare për të kthyerit. Mundësitë e shkollimit në Kosovë ende janë të kursyera. Duke filluar nga viti 2001, UNMIK-u ka punuar në mënyrë intensive për të prezentuar projekte të ndryshme për të integruar minoritete të ndryshme në shkollat e njejta. Për shembull në Bincë, organizata italiane Caritas Italiana ka formuar një qendër shkollimi multietnik për furnizim, dialog dhe bashkpunim.

Sistemi i shëndetsisë në Kosovë vuan nga mungesa e kapacitetit. Si rjedhje e luftës së vitit 1998-1999 dhe nga rëmujat pasuese nga konfliktet ndëretnike shumë kosovarë vuajnë nga lëndimet psikike. Në bazë të një hulumtimi amerikan nga viti 2001, 25 % e popullatës së përgjithshme ose 475.000 persona vuajnë nga streset posttraumatike. Edhe pse lufta ka mbaruar por lufta vazhdon ende tek kryet e shumë njerëzve.

### **Enti Danez Për Ndhimë Të Refugjatëve**

Enti Danez Për Ndhimë Të Refugjatëve ka qenë prezente në Kosovë nga viti 1998, dhe punonë për tu ndihmuar refugjatëve dhe të deportuarve të vendit për të gjetur një zgjidhje të pranueshme për situatën e tyre.

Enti Danez Për Ndhimë Të Refugjatëve ndihmon duke :

- dhënë mbështetje të deportuarve të regjionit duke marë vendime për tu kthyer, duke i informuar në mënyrë të detajuar.
- dhënë bursa të vogla ,që I mundëson të kthyerve të fitojnë të ardhura dhe si të tillë ta bëjnë veten të pamvarur nga ndihmat nga jashtë.
- rindërtimin e infrastruktures
- mbështetje të refugjatëve të kthyer në vendlindje dhe të deportuarit lokal duke rindërtuar shtëpitë e tyre dhe duke dorzuar mjetet e nevojshme për kuzhinë, vegla të formave të vogla për bujqësi ose për shembull tepikë ose shtrat.
- mbikqyrjen e grupeve etnike për të parandaluar konfliktet e reja dhe për të krijuar kushte për kthim në shtëpi të shumë refugjatëve.

### **Oferta për kosovarët në Danimarkë**

Enti Danez Për Ndhimë Të Refugjatëve, Care4You Association dhe Kryqi I Kuq Danez ofrojnë këshilla të ndryshme dhe oferta për shkollim për kosovarët në Danimarkë. Më poshtë mund të lexoni për ofertat e ndryshme.

### **Këshillat e Entit Danez Për Ndhimë Të Refugjatëve për azilkërkuesit nga Kosova**

Enti Danez Për Ndhimë Të Refugjatëve pos tjerash ofronë edhe këshilla për të gjithë kosovarët me status të refuzuar të lejeqëndrimit në Danimarkë (negativ). Gjatë këshillimit ju do të keni mundësi që të bisedoni me një jurist për lëndën e azilit tuaj dhe me një këshilltarë me përvojë për riatdhesim për mundësitë dhe përparsitë që i keni për të udhëtuar për në shtëpitë e juaja në Kosovë.

Gjatë bisedave grupore të mëhershme me kosovarët njëra nga pyetjet e shpeshta që është parashtruar ishte se a ka mundësi që Enti Danez Për Ndhimë Të Refugjatëve të ndihmojë për të fituar lejeqëndrimi në Danimarkë. Në Danimarkë janë autoritetet daneze ata që japin lejeqëndrimi, mirpo Enti Danez Për Ndhimë Të Refugjatëve –si organizatë humanitare –ka disa mundësi për të shtruar disa pyetje të vecanta drejtuar autoriteteve daneze për azil. Për k’te arsye Enti Danez Për Ndhimë Të Refugjatëve mundë tju ofrojë juve që ta shikojë lëndën tuaj me një këndvështrim të ri, për të verifikuar egzistimin e mundësive të pashfrytzuara deri më tani.

Enti Danez Për Ndhimë Të Refugjatëve gjithashtu ka biseduar me persona, të cilët kanë qenë të interesuar se cilët do të ishin mundësitë nëqoftëse eventualisht do të heqnin dorë nga jeta e qendrave të azilit në Danimarkë dhe që dëshirojnë të kthehen në Kosovë. Këtu keni mundësi që të përfitoni forma të ndryshme të ndihmave si për shembull:



Letër me lajme të reja për kosovarët në Danimarkë, mars 2006

- 1) pranimit dhe transportimi deri në adresën e paralajmëruar të shtëpisë, pako fillestare me mobilje, ushqim, artikuj higjienik, mjete etj..
- 2) ndihma praktike për shembull për tu regjistruar tek autoritetet lokale etj.
- 3) ndihma me reparime të vogla të shtëpisë, pagesa e qirasë për një periudhë të shkurtër dhe të ngjajshme.
- 4) ndihma për aktivitete që sjellin përfitime përshembull mjete për zejtari

Enti Danez Për Ndhmë Të Refugjatëve do të vije vazhdimisht nëpër qendrat e azilit. Ju natyrisht jeni të mirseardhur që të na kontaktoni eventualisht nëpërmjet të puntorëve të qendrës në telefonin numër :3373 5230. Ta keni parasyshë se cdo të marte nga ora 1300-1400 do të ketë këshilla telefonike në gjuhën shqipe/serbokroate.

### **Të ardhurat në Kosovë –këshillimet dhe mundësit për huazim**

Nëse mendoni që të ktheheni në vendlindje, dhe jeni i dyshimt për mundësit tua për të patur të ardhura të regullta ,për k'te ju ofron Care4you Association këshilla për zejtari dhe për startimin e një firme te vogël personale në Kosovë. Kjo do të ishte për shembull se si duhet të pregaditni planin për zejtari, mundësitë për të huazuar shuma të vogla dhe të lira në Kosovë. etj. Ju mundeni ta kontaktoni Søren Egdal nga Care4You Association në email: [se@care4you.dk](mailto:se@care4you.dk) ose në telefonin celular: 2044 2468.

### **Kurset në Danimarkë**

Do të ishte ide e mirë që ti përmirsoni aftësitë dhe dijeninë tuaj në zejtari para se të ktheheni në Kosovë. Kjo përmirson mundësinë për të përfituar një punë dhe si i tillë të ardhura të mjaftueshme për të mbajtur një familje. Në Kryqin e Kuq Danez mundeni të merni pjesë në një numër të konsiderueshëm të kurseve të ndryshme, për shembull Patentë për kompjuter, kurse për mirmbajtjen e banesave, kurse për media, ose kurse konkrete që ju jepë mundësinë për njohuri të startimit të firmës personale.

Për informata të mëtejshme kontaktoni Shtëpinë e Kulturës së Kryqit të Kuq Danez dhe bisedoni me Lars Brøgger në telefonin :3296 0088 ose email [lab@redcross.dk](mailto:lab@redcross.dk)

### **Refugjatët me lejeqëndrimi mundë të marin mbështetje për tu kthyer në shtëpi**

Nëse jeni refugjatë me lejeqëndrimi, i huaj me lejeqëndrimi humanitarë, bashkim familjar, ose emigrant dhe dëshironi të ktheheni në shtëpi për të vazhduar jetën e përhershme në Kosovë, në bazë të ligjit për riatdhesim mundeni që të bëni kërkesë për ndihmë për tu kthyer në shtëpi.

Ndihma ekonomike pos tjerash përmban:

- Biletë aeroplani për vendlindje
- Transportimin e vlerave personale
- Ndihmë për tu gjindur në vendlindje
- Blerjen dhe transportimin e mjeteve për zejtari.



**Dansk Flygtningehjælp**  
Giv flygtninge en fremtid

Letër me lajme të reja për kosovarët në Danimarkë, mars 2006

Enti Danez Për Ndihmë Të Refugjatëve ofron këshilla dhe informata për shqiptarët të cilët dëshirojnë të kthehen prapa. Ju mundë të gjeni broshura dhe informata tjera në webfaqen tonë: [www.flygtning.dk/atvendehjem](http://www.flygtning.dk/atvendehjem) Ju gjithashtu mundeni ta kontaktoni këshilldhënësen në Enti Danez Për Ndihmë Të Refugjatëve Anne-DorthenHelmich në numrin e telefonit 3373 5230 ose Vagn Larsen në numrin :3373 5231